



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:197131

Datë: 25.11.2019

Numri i dokumentit: 00672466

C.nr.3600/2018

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEPARTAMENTI I PËRGJITHËM, Divizioni Civil, me gjyqtaren Mihane Ismajli, në çështjen juridike kontestuese të paditësit Sh.B., adresa: rr. “2.N.” , Blloku ..., HY .../..., nr..., F.K. , të cilën sipas autorizimit e përfaqëson N.A.av. nga Prishtina, kundër të paditurave Ministria e Financave dhe Dogana e Kosovës- Prishtinë të cilat i përfaqëson sipas autorizimit N.K., avokate nga avokatura shtetërore, me objekt të padisë anulim vendimi , dhe anulim konkursi, pas përfundimit të shqyrtimit kryesorë – publik të mbajtur me datë 16.09.2019, në prani të paditësit dhe të autorizuarit të tij e në mungesë të të paditurave morr këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET në tersi e bazuar Kërkesëpadia e paditësit Sh.B., adresa: rr. “2.N.” , Blloku ..., HY .../..., nr..., F.K.,

II. ANULOHET si i kundërligjshëm Vendimi nr. 43/2018 i të Paditurës së parë Ministria e Financave me nr. të protokollit 01/1706-2 i datës 17.06.2018 dhe Anulohet Konkursi i Brendshëm nr. 05.6.1/1068 i shpallur me datë 08.06.2018 nga Dogana e Kosovës.

III. DETYROHE: Drejtori i Përgjithshëm i Doganës së Kosovës ta rishpallë konkursin e brendshëm duke i eliminuar të metat e konstatuara gjatë zhvillimit të procedurës së konkursit të brendshëm nr. 05.6.1/1068 i datës 08.06.2018, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh , nga data e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

IV. KONSTATOHET i tërhequr propozimi i paditësit për caktimin e masë së përkohshëm për pezullim të vendimeve.403/04/10/2018/,2018 dhe 405/4/10/2018,

V. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Duke ju referuar pohimeve në padi, deklarimeve të dhëna gjatë procesit gjyqësor dhe fjalës përfundimtare paditësi përmes të autorizuarit të tij ka kërkuar që të anulohet vendimi nr. 43/2018 i të Paditurës së parë Ministria e Financave me nr. të protokollit 01/1706-2 i datës 17.06.2018 dhe Anulohet Konkursi i Brendshëm nr. 05.6.1/1068 i shpallur me datë 08.06.2018 nga Dogana e Kosovës me propozim për masën e përkohshme për ndalimin e ekzekutimit të vendit me nr. 403/04/10/2018 /2018 dhe 405/4/10/2018, mirë po në seancën dëgjimore pala paditëse ka hequr dorë nga propozimin i masës së përkohshme me qëllim të shqyrtimit të çështjes kryesore, si dhe të detyrohet, Drejtori i përgjithshëm i Doganës së Kosovës ta rishpallë konkursin e brendshëm duke i eliminuar të metat e konstatuara gjatë zhvillimit të procedurës së konkursit të brendshëm nr. 05.6.1/1068 i datës 08.06.2018, të protokolluar nr. 01/1706-2 të datës 21.09.2018. Më tutje ka shtuar se kërkesëpadija e paditësit është e bazuar në ligj nga se në bazë të provave paraqitura është vërtetuar se institucionet të cilat janë të paditura kanë shkelur me apo pa qëllim rregullat në bazë të të cilave në kushte normale të kishte kaluar e ter procedura e konkursit, në këtë konkurse ka marrë pjesë edhe paditësi. Paditësi pretendon se konkursi nuk është shpallur kon formë dispozitive të nenit 49 të UA me nr. 37/2016 i cili Udhëzim Administrativ më pas u është ndryshua dhe plotësuar me atë të nr. 45/2017, gjithashtu është shkelur edhe barazia gjinore , si dhe përbërja e komisionit nuk është shpallur komfor dispozitive të Udhëzimit Administrativ me nr. 37/2016 . I ka propozuar gjykatës që pas administrimit të provave ta aprovojë në tersi kërkesëpadiinë e paditësit, shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Të paditura nuk kanë prezantuar në seancën e shqyrtimit kryesor edhe për kundër faktit se janë ftuar në mënyrë të rregullt sipas flete kthese së datës 11.06.2019 të njëjta mos ardhjen në seancë nuk e kanë arsyetuar e as paralajmëruar , me propozimin e të autorizuarit të paditësit e kon formë nenit 423 par. 4 të LPK-së, gjykata e ka mbajtur shqyrtimin kryesor në mungesë të paditurave. Të paditurat për mes përfaqësueses së tyre të autorizuar në përgjegjëseje në propozim për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit të datës 27.12.2018 e kanë kundërshtuar në tersi padinë e paditësit si dhe caktimin e masë së përkohshme të sigurimit, me arsyetim se vendimi i atakuar është marrë kon formë ligjit , andaj bazuar në këtë nuk ka as edhe një bazë ligjore për caktimin e masës së përkohshme të sigurisë , siç; shihet paditësin me as një provë nuk e ka dëshmuar të kundërtën e asaj që thuhet në arsyetimin e vendimit të atakuar. I ka propozuar gjykatës që të refuzohet propozimi për caktimin e masës së përkohshme të sigurisë si i pa bazuar.

Për të vlerësuar drejtë dhe për të vërtetuar gjendjen faktike lidhur me çështjen juridike konkrete në shqyrtimin kryesor- publik të mbajtur me datë 16.06.2019, me propozimin e paditësit gjykata bëri administrimin e provave edhe atë :Vendimin e Qeverisë së Kosovës – Ministrisë së Financave me nr. 43/2018 i protokolluar me nr. 460/01 datë 21.09.2018, ankesa nr. 01 1653 të datës 27.08.2018, Udhëzimi Administrativ për rregullimin e marrëdhënies së punës me nr. 01.V 449/2016 datë 19.12.2016, konkursi i brendshëm, nr. 05//61/1068 datë. 08.06.2018, konkursi i brendshëm nr. 288 datë 23.06.2017, Rekomandimi nr. 437/09 /098 /2017, Vendimi mbi ratifikimin e rekomandimit të komisionit të ankesave nr. 437/ /09.08.2017 , me nr. të protokollit 01/447/2017 dt. 21.08.2017, përshkrimin i detyrave të punës nr. i dosjes) 2017 me nr. të referencës 39/2017 , Vendimi i Doganë së Kosovës nr. 05.6.1 dt. 01.08.2018 , nr. i protokollit 092/02208/2018, njoftimi për kandidatë të suksesshëm i dt. 17.08.2018, nr. 01/353/2018, Vendimi i Ministrisë së Financave me nr. të protokollit

403/04/2018, Vendimi i Ministrisë së Financave nr. 405/04/10/2018, formularët e intervistave të dt. 15.08.2018 Emalin dt. 25 shtator 2018 , Orari , lëndët dhe procedura e mbajtjes së 16.11.2017 gradë OD6 të shpallur sipas konkursit të brendshëm me nr. të protokollit 068/0806/2018, formulari për aplikim të brendshme me nr. 10/18/1068 i dt. 22.06.2018, Mendimi juridik i Avokatit të Popullit të Republikës së Kosovës , nr. 778/2019 dt. 03.09.2019, Udhëzimi Administrativ nr. 01/562/2017 datë 16.11.2017,Udhëzimi Administrativ nr. 01/67/2017 datë 17.03.2017 dhe Udhëzimi Administrativ nr. 01/624/2017 datë 28.12.2017.

Pasi që Gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave se bashku, mbështetur në dispozitat nga neni 8 i Ligjit për Procedurën Kontestimore,(LPK-së) arriti në përfundimin se në këtë çështje juridike kontestimore duhet vendosur sinë dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Nga administrimi i të gjitha provave gjykata gjeti se : e paditura e dytë Dogana e Kosovës me datë 08.06.2018 ka shpallur konkurëstë brendshëm nr. 1068 për plotësimin e vendeve të lira drejtor i drejtorisë grada OD6, numri i pozitave të lira 3/tre, në kundërshtim me dispozitat e paragrafeve 3 dhe 7 të nenit 49 të Udhëzimit Administrativ nr. 37/2016 për Rregullimin e Marrëdhënies së punës të oficerëve doganor, dhe në kundërshtim me dispozitat e neneve 8,9 dhe 11 të Udhëzimit Administrativ nr. 39/2017 për Strukturat Organizative të Doganës së Kosovës.

Gjykata ka gjetur se konkursi i brendshëm nr. 1068 është në kundërshtim të plotë me dispozitat e nenit 49 par. 3,7.1 dhe 7.3 të UA nr. 37 /2016 , kjo për faktin se në konkurës janë shpallur tri /3 pozita të lira të përgjithëshme me një titull të punës “Drejtor Drejtorie” me vetëm një përshkrim të përgjithshëm të detyrave të punës, duke kërkuar vetëm diplomë universitare, pa specifikuar profilin e caktuar të pozitave të lira. Ashtu që Drejtori i Përgjithshëm ka qenë i detyruar që konkursin ta shpall konformë kriterëve të përcaktuara me dispozita të nenit 49 të Udhëzimit Administrativ nr. 37/2016 për Rregullimin e Marrëdhënies së punës së oficerit doganor, ku në paragrafin 3 thuhet “Për të gjitha rastet e avancimit duhet të jen shpallur konkurse të brendshme për vende të lira për atë nivel të caktuar dhe të përmbushen kriteret për avansim bazuar në UA dhe përshkrimet e vendeve të punës , respektivisht përshkrimet të vendit të punës për profile të caktuara profesionale kur ato i kërkon pozita dhe profili i tillë“ Pastaj në paragrafin 7.3 të të njejtit nen parashihet se “ Për nivelin N4 –OD\$ deri te niveli N6 –OD6 kërkohet diplomë universitare, respektivisht kërkohet diplomë universitare e profilit të caktuar.“Në konkursin e shpallur nuk janë konkretizuar tri pozita të lira që kërkohen të plotësohen, nuk janë specifikuar se për cilat drejtori është shpallur , nuk është cekur përshkrimi specifik i detyrave të punës, nuk janë specifikuar diplomat universitetes për secilin drejtor, titullin e postit të lirë sipas njësisë në kuadër të strukturës organizative si dhe profilet profesionale për secilin drejtor të përcaktuar në nenet 8,9 dhe 11 të Udhëzimit Administrativ nr. 39/2017 që përcaktojnë përgjegjësit bazike të niveleve hierarkike.

Gjykat në shkresat e lëndës ka gjetur edhe konkursin e brendshëm të shpallur nga e paditura me datë 23.06.2017 me nr. 288 me përmbajtje identike sikur konkursi 37/2016 nr. 1068 i kontestuar . Komisioni i ankesave i formuar sipas vendimit të DP , duke trajtuar pretendimet ankimore të parashtruara përmes ankesës nr. 312 të datës 24.07.2017, ka rekomanduar Drejtorinë e Përgjithshëm ta anuloi konkursin në fjalë më arsyetim se nuk janë përmbushur kriteret e paragrafit 7 të nenit 49 të Udhëzimit Administrativ nr. 37/2016. Bazuar në rekomandimet e komisionit të ankesave , Drejtori i përgjithshëm ka anuluar konkursin nr. 288

të datës 23.06.2017 i shpallur në të njëjtën formë dhe për të njëjtat pozita të lira sikurse konkursi tani i kontestuar.

Pastaj Drejtori i Përgjithshëm i Doganave të Kosovës me datë 01.08.2018 ka marrur vendimin me nr.392 për formimin e komisionit intervistues në perbërje prej 5/pesë anëtarve edhe atë: B.R. – Kruetar i Komisionit- Dogana e Kosovës, Sh.M. – anëtar- Ministria e Financave, M.H.- anëtar – Ministria e Punëve të Brendshëm, Sh.G.- anëtar – Policia e Kosovës dhe H.M. anëtar – Administrata Tatimore e Kosovës, të gjithë të gjinisë mashkullore, ashtu që gjykat vlerëson se e paditura ka vepruar në kundërshtim me dispozitën e nenit 54.3 UA nr. XX/2016, ku parashihet “ Të pakten , një anëtar i komisionit përzgjedhës , me përgjastim të ndjeh rrethane ekzistuese , do të përbëhet nga gjinia femrore, siç: është përcaktuar me ligj”.

Nga përmbajtja e konkursit të brendshëm gjykata ka gjetur se konkursi kontestues është hartuar dhe nënshkruar nga udhëtruesi i detyrës së departamentit për burime njerzore, i cili gjithëashtu ju ka nënshtruar të gjitha procedurave të avansimit sipas këtij konkursi dhe ishte kandidatë potencial për fitimin e njerës nga pozitave të lira të shpallura , andaj gjykata vlerëson se një veprim i tillë është i kundërligjshëm , nga se paraqet konflikt intersei. Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 6 të ligjit, nr. 06/L-011 për parandalimin konflikti, se “ konflikti i interesit lind nga një rrethanë në të cilën zyrtari ka interes privat që mund të ndikoj ose duket të ndikon në kryerjen me paanshmëri dhe objektivitet të detyrës së tij zyrtare, ndersa në nenin 9 po të njëjtit ligj theksohet se;” Zyrtari nuk mund të përdor pozitën apo funksionin e vet për të avansuar interesat e veta personale . Veprimet e ushtruesit të detyrës të DBNJ janë gjithëashtu në kundërshtim dhe “2 edhe me nenin 127 par. 1 të UA nr. 37/2016 i cili parasheh se : “Oficeri Doganor nuk duhet të pranoj pozita , obligime dhe nuk duhet të jetë pjesëmarrës në çfar do aktiviteti i cili krijon konflikt interesi me detyrën zyrtare”.

Komisioni intervistues duke iu referuar paragrafit 3 të nenit 49 të UA nr. 37/2016 i cili thekson se :” Procedurat e përzgjedhjes për avansim përcaktohen paraprakishtë nga Dogana e Kosovës bazuar në kriteret përkatës”. Ka hartuar paraprakishtë formularin e intervistës dhe ka përcaktuar kriteret e vlerësimit . Në fund të çdo formulari të intervistes është dhënë sqarim si në vijim 1 “ Komisioni nuk mund të vlerësoi më me shumë se një pikë diferencë” dhe “2 Në rast të vlerësimit të tillë , kryesuesi duheturohet të harmonizoj notat e vlerësimit bazuar në fakte dhe arsyetime përkatëse nga anëtarët e panelit intervistues”. Nga formularët e intervistes së paditësit gjykata ka gjetur se komisioni intervistues gjatë zhvillimit të procedurave të avansimit duke vlerësuar me më shumë se një pikë diferencë , ka bërë shkelje të rregullave të konkursit të vendosura në rubricën 1 dhe 4 dhe pikët e anëtarit të dytë të komisionit të vendosura në rubrikën 3, janë dy pikë më pak në raport me vlerësimet e anëtarëve tjerë të komisionit intervistues , gjithëashtu e njëjta situatë paraqitet edhe në totalin e pikëve të vlerësuar , ku vlerësimet e këtyre dy anëtarëve të komisionit janë dukshëm me poshtë në raporte me anëtarët tjerë të komisionit. Anashkalimi i kriterëve të vlerësimit të caktuar paraprakishtë nga komisioni vlerësues , duke lejuar vlerësimin më me shumë se një pikë diferencë , për fushat e njëjta të vlerësimit, verteton faktin se Komisioni Intervistues ka vepruar në kundërshtim me kriteret për vlerësimin e kandidatëve të përcaktuar paraprakishtë nga vet komisioni intervistues si dhe kanë vepruar në kundërshtim me parimet dhe procedurat e avansimit të përcaktuara me nenin 46 të UA nr. 37/2016, ku është shkelur neni 2 i këtij udhëzimi ku përcakton se: “ avancimet e oficerëve doganor kryhen duke zbatuar mekanizmat transparent dhe objektivat që kanë si qëllim të verifikojnë plotësimin e kërkesave dhe kriterëve të parapara”.

Komisioni intervistues ka hartuar orarin, lëndët dhe procedurat e mbajtjes së intervistave verbale, ka zhvilluar për tri ditë rreshtë intervista, por duke mos publikuar në fund të çdo dite rezultatin e intervistës gojore ka shkelur dispozitën e nenit 53.7 të Udhëzimit administrativ 37/2016 i cili përcakton se:” në fund të çdo seisoni të provimit komisioni përzgjedhës duhet të përgatisë një listë të kandidatëve të shqyrtuar dhe rezultatet përkatëse të marrura të publikohen në vend ndodhjen e provimit po atë ditë.

Paditësi me datë 27.08.2018 ka ushtruar ankesë Ministrisë së financave kundër konkursit të brendshëm të shpallur nga Dogana e Kosovës me nr. të protokolit 05.6.1/1068//08.06.18, për plotësimin e pozitave të lira OD6 në Doganën e Kosovës dhe Njoftimin për kandidatë e suksesëshëm, nr. Protokoli 0/353/2018 datë 18.03.2018, me arsyetim se në rastin konkretë janë shkelur dispozitat ligjore të udhëzimeve administrativ e të paditurës dhe gabimishtë është vertetur e drejta materiale.

Ministria e financave me vendimin nr. 43/2018 të datës 21.09.2018 e ka refuzuar ankesën e paditësit, me arsyetim se Komisioni pas administrimit të provave të shkresave të lëndës ka konstatuar se i tër procesi i rekrutimit të kandidatëve për tri npozita të lira të publikuar në konkursin e brendshëm për drejtor të drejtorisë në Doganën e Kosovës me nr. 05.6.1/108, datë 06.08.2018 është zhvilluar në përputhje të plotë me legjislacionin doganor, Kodin Doganor dhe Aakcizave të Kosovës nr. 03/ L-109 i plotësuar dhe ndryshuar me ligjin nr.04/1-099, Udhëzimin Administrativ nr. 37/2016 për Rregullorën e Marrëdhënies së Punës së oficerit doganor.

Gjykata vlerëson se vendimi i Ministrisë së Financave nr. 43/2018 I datës 21.09.2018 si i tillë është i paligjshëm sepse është sjellë në kundërshtim me dispozitat e nenin 48 dhe 52 të Ligjit 05/L- 131 i Procedurës së Përgjithëshme administrative që rregullojnë formën dhe elementet e detyrueshme të aktit administrativ si dhe në kundërshtim me nenin 4,45,46,49 ,53 dhe 127 të UA nr. 37/2016 për Rregullorën e Marrëdhënies së Punës së Oficerit Doganor, neneve 8,9 dhe 11 të UA nr.39/2017 për strukturat organizative të Doganës së Kosovës, dhe nenit 5 dhe 6 të ligjit nr. 06/L-011 për konfliktit të të interesit në Ushtrimin e funksionit publik. Ky vendim i të paditurës është i kundërligjshëm për faktin se e paditura nuk ka cekur faktet në bazë të të cilave është marrur vendimi, nuk ka cekur shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave, pastaj nuk ka dhënë përgjegjeje në pretendimet ankimore të paraqitura nga paditësi, andaj duke mos dhënë as një përgjegjeje në pretendimet ankimore të paditësit të paraqitura në ankesë nuk është lëshuar fare në zbatimin e së drejtës material, ashtu që gjykata vlerëson se e paditura ka bërë shkelje esenciale të dispozitave nga paragrafi 2 të nenit 48 të LPPA- Ligji nr. 05/L-031 përcaktohet “ Një arsyetim që është dukshëm i pa mjaftueshëm, i pa qartë, kundërthënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij “.

Lidhur me kësaj çështje juridiko kontestuese gjatë vendosjes së saj gjykat mori për bazë edhe Mendimin juridik i avokatit të popullit të Republikës së Kosovës në cilësinë e mikut të gjykatës (AMICUS CCURIAE) për gjykatën themelore në Prishtinë me nr. 78/2019 të datës 03/05/2019 me çrastë tek pjesa e konkluzioneve, nder të tjera avokati i popullit jap konstatime: Pika 38. “ Avokati i popullit konstaton se vendimi me nr. 392 datë 2. Gushtë 2018 me të cilin është formuar komisioni për intervistim dhe vlerësimin e kandidatëve nuk është në përputhje me

ligjin nr. 05/021 për mbrojtjen nga diskriminimi si dhe nenin 6 par 8 të ligjit nr. 05/L-020 për Barazi gjinore,”

Nga provat e administruara si më lartë, dhe dispozitat ligjore të lartcekura gjykata vlerëson se kërkesëpadia e paditësit është **bazuar** sepse gjatë shqyrtimit gjyqësor u vërtetua se Vendimi nr. 43/2018 i të Paditurës së parë Ministria e Financave me nr. të protokollit 01/1706-2 i datës 17.06.2018 dhe Konkursi i Brendshëm nr. 0506.1/1068 i shpallur me datë 08.06.2018 nga Dogana e Kosovës janë të kundërligjshëm, andaj edhe të njëjtit i anuloi si të kundërligjshme. dhe e detyroi të paditurin- Drejtorine Përgjithshëm i Doganës së Kosovë ta rishpallë konkursin e brendshëm duke i eliminuar të metat e konstatuara gjatë zhvillimit të procedurës së konkursit të brendshëm nr. 05.6.1/1068 i datës 08.06.2018.

Meqenëse paditësi në seancën dëgjimore e ka tërhequr propozimin për caktimin e masës së përkohëshme të sigurisë , andaj gjykata sipas dispozitën e nenit 261 të LPK- së e konstatoi se propozimi për caktimin e masës së përkohëshme të sigurisë është tërhequr .

Vendimin që sejcila palë t'i bartë shpenzimet e procedurës, Gjykata e ka mbështetur në dispozitën nga neni 450 , të Ligjit për Procedurën Kontestimore /LPK/-së .Pasi që as njera palë nuk i ka kërkuar shpenzimet e procedurës.

Prandaj, bazuar në të lartcekurat dhe duke ju referuar nenit/eve 4, 5, 7, 8 dhe 10 lidhur me nenin 143 të Ligjit mbi procedurën kontestimore (LPK), gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË- Departamenti i Përgjithshëm
C.nr. 3600 /2018, datë 16.09.2019**

**Gj y q t a r j a,
Mihane Ismajli**

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 dite, nga dita e pranimit të njëjtit , Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e përmes kësaj gjykate.